



Pranimi / Dorezuar Punimja / Protokoll Received / Delivery	02.02.23	3	viti god. Year
Organ / Njësia Org. / Jednica Org. / Unit	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. No.	Shënimi Prilog. Appendix	Sasia Kopimit Quantity
SKRIPSHICK	1279/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.07/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1110/2022 të datës 07.12.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit KA.nr.39/22 të datës 25.11.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 02.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.1110/2022 të datës 07.12.2022 të parashtruar nga ankuesja

Arsyetim

Ankuesja e punësuar në pozitën Sekretare Juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë -dega Lipjan, përmes postës më datë 07.12.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më të njëjtën datë dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.1110/2022 me numër protokoll 7724/2022, kundër Vendimit KA.nr. i datës 25.11.2022 me numër protokoll 01-2127 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.12.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të

ankueses në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 13.01.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 7724/2022 të datës 07.12.2022; Raportin Specialistik të ankueses të lëshuar nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar I Kosovës me numër protokollit 7377/2022 të datës 06.07.2022; Faturën e lëshuar nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar I Kosovës për ankuesen me numër Fature: ORT45118 të datës 06.07.2022; Raportin e Shërbimit ambulator kardiologjik "Zemra" të ankueses të datës 24.01.2015; Raportin e Shërbimit ambulator kardiologjik "Zemra" të ankueses të datës 13.11.2020; Raportin e Shërbimit ambulator kardiologjik "Zemra" për ankuesen të datës 07.11.2020; Analizat e lëshuara nga Laboratori Hematologjik-Biokimik "Internistika" për ankuesen me numër protokollit 19 të datës 13.01.2021; Raportin e lëshuar nga Ordinanca Mjekësore "Internistika" për ankuesen të datës 13.01.2021; Kërkesë për pensionim të parakohshëm të parashtruar nga ankuesja për Drejtorin e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me numër protokollit 883 të datës 07.07.2022; Kërkesë e dërguar përmes e-mailit nga për dhe të datës 18.07.2022; E-mail i dërguar nga për I datës 20.07.2022; Plotësim I kërkesës për pensionim të parakohshëm të parashtruar nga ankuesja për Drejtorin e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me numër protokollit 4093 të datës 18.07.2022; Kërkesë e parashtruar nga ankuesja për Gjyqtarin Mbikëqyrës me numër protokollit 4133 të datës 19.07.2022; Njoftim I parashtruar nga ankuesja për Drejtorin e Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës me numër protokollit 4567 të datës 02.09.2022; Kërkesë e parashtruar nga ankuesja për Gjyqtarin Mbikëqyrës me numër protokollit 5642 të datës 27.10.2022; Përgjigje në kërkesën e ankueses e lëshuar nga Gjyqtari Mbikëqyrës e datës 27.10.2022; Ankesë e parashtruar nga ankuesja për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datën 27.10.2022; Vendim i lëshuar nga Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për ankuesen me KA.nr.39/2022 dhe numër protokollit 01/2127 të datës 25.11.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e dërguar nga KSHMPCK-ja për Udhëheqësin e personelit në Sekretariatit Këshillit Gjyqësor të Kosovës me numër protokollit 7796/2022 të datës 08.12.2022; Përgjigje në ankesën A.nr.1110/2022 të dërguar nga Sekretariati I Këshillit Gjyqësor i Kosovës për KSHMPCK me numër protokollit 258 të datës 13.01.2023; Përgjigje në kërkesën e ankueses të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan nga Gjyqtari Mbikëqyrës me numër protokollit 375/22 të datës 28.10.2022; Vendim i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës për ankuesen me numër Reference DS-1011-2022 të datës 04.10.2022; Fletëkthimi i Postës së Kosovës nga ankuesja për Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 29.11.2022 me lloj të dërgesës 01/2127 KA;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, konstaton se është plotësuar kërkesa ligjore për përfundim të procedimit administrativ e filluar me ankesën me numër A.nr.1110/2022 të datës 07.12.2022 e parashtruar nga ankuesja *sepse:*

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës Kolegji, gjënë së ankuesja me datë 07.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7724/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa më datë 01.02.2023 ankuesja ka parashtruar kërkesë për tërheqje të ankesës me numër protokoll 1177/2022 të datës 01.02.2023 me arsyetim se: "bëjë tërheqjen e ankesës të dorëzuar me datë 07.12.2022 për shkaqe personale". Në bazë të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 103 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë" dhe neni 104 ku përcaktohet se: "Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot", andaj duke u nisur nga veprimi administrativ i ankueses për tërheqjen e ankesës së parashtruar në Këshill, Kolegji konstaton që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.1110/2022 e datës 07.12.2022 e parashtruar nga ankuesja


Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS


Lënda, A.nr.1110/2022, datë 02.02.2023

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arbën MEHMETI



Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

